

BULETINI COVID-19 NJU JORK PËRDITËSIM

Të dashur punonjës,

Sot, Guvernatori i Nju Jorkut ka shpallur një udhëzim për mbylljen e bizneseve jo jetike. Në të në njëjtën kohë, ai i lejon, dhe në fakt u kërkon, të gjitha "Bizneseve Jetike" të qëndrojnë të hapura për t'u shërbyer komuniteteve. Për shkak të rëndësisë të produkteve që Vantage Northeastern Region Service Center and GAL Bronx prodhon dhe ofron për industrinë e ashensorëve, ne jemi një biznes jetik dhe për këtë arsye nuk do të mbyllemi me përjashtim të ndonjë udhëzimi të ri që kërkon ta bëjmë këtë.

Duhet të jemi të gjithë krenarë për faktin se u ofrojmë pjesë kritike për ashensorë shumë industrive të rëndësishme. Ndër të tjera, këto përfshijnë prodhimin e produkteve ushqimore, për kujdesin shëndetësor, për jetesën me asistencë dhe për të gjitha format e industrisë së transportit. Pa produktet tona këto industri do të përballeshin me vështirësi të mëdha për të ofruar nivelin e sigurt të shërbimeve që nevojitet në këtë kohë kritike. Përveç këtyre industrive, operimi i sigurt i ashensorëve në ndërtesat e banimit është një funksion kyç që ofrohet nga produktet tona ndaj komuniteteve kudo që ndodhen. Të gjithë kemi pjesëtarë të familjes që jetojnë në apartamente dhe që mbështeten në funksionimin e sigurt të ashensorëve të tyre.

Nëse nuk udhëzohet ndryshe, do të vazhdojmë të qëndrojmë të hapur për të ndihmuar në shërbimin ndaj klientëve tanë dhe komunitetit.

Përparësia jonë kryesore, është dhe do të jetë gjithnjë shëndeti, siguria dhe mirëqenia juaj. Jemi duke marrë masa të jashtëzakonshme për të mbrojtur punonjësit tanë dhe masa parandaluese shtesë për të pasur ambiente të sigurta Jini të sigurt se jemi të angazhuar për të bërë gjithçka që kemi në dorë për të garantuar që secili të jetë i sigurt dhe i shëndetshëm.

Ju falënderojmë për angazhimin tuaj të vazhdueshëm dhe do të vazhdojmë të marrim masat e nevojshme parandaluese për të promovuar ambiente pune të sigurta dhe të shëndetshme për të gjithë punonjësit.

Nëse keni ndonjë pyetje ose shqetësim lidhur me përmbajtjen e këtij njoftimi, ju lutemi të kontaktoni Partnerin tuaj të Biznesit për Burimet Njerëzore ose Drejtuesin tonë të Task Forcës për COVID-19 [Mishelle Williams](#).

Me respekt,

Task Forca për COVID-19